



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2026

"PËR

KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË SHTETËRORE TË PYJEVE"

Bazuar në nenin 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka për objekt krijimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve (në vijim Shoqëria) si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e saj

Neni 2

Objektivat e shoqërisë

Shoqëria Shtetërore e Pyjeve ka këto objektiva kryesore:

- a) zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve, në përputhje me legjislacion sektorial;
- b) mbrojtjen dhe rehabilitimin ekosistemeve pyjore;
- c) krijimin dhe administrimin e fidanishteve shtetërore;
- ç) rritjen dhe ruajtjen e vlerës së aseteve natyrore pyjore;
- d) kontributin në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin rural ;

dh) zbatimin e politikave shtetërore dhe standardeve ndërkombëtare në menaxhimin pyjor.

Neni 3

Parimet e përgjithshme

1. Në përmbushjen e funksioneve të saj Shoqëria udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:
 - a) përparësia e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjen me politikën shtetërore të zhvillimit;
 - b) respektimi i parimit të autonomisë vendore dhe bashkëpunimit me njësitë e vetqeverisjes vendore për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në këtë sektor;
 - c) e ekonomisë së tregut dhe realizimin e objektivave me interes publik në fushën e mjedisit.
 - ç) zbatimi me efektivitet, eficiencë, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
 - d) zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
2. Përveç parimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, Shoqëria udhëhiqet edhe nga parime e kritere të tjera, të përcaktuara në statut dhe në aktet e tjera të saj, si dhe në marrëveshjet respektive me institucionet dhe/ose palët e treta.

Neni 4

Statusi juridik

1. Shoqëria krijohet si person juridik në formën e një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, sipas ligjit për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare dhe këtij ligji.
2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministri përgjegjës për pyjet.
3. Shoqëria sh.a. ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës.
4. Shoqëria ka selinë në Tiranë dhe ka të drejtë të krijojë degë apo njësi operative rajonale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nevojave organizative dhe operacionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Funksionet e Shoqërisë

1. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet dhe pa cenuar kompetencat e autoriteteve publike përgjegjëse dhe të njësisë të vetqeverisjes vendore në fushën e administrimit dhe menaxhimit të fondit pyjor.
2. Për realizimin e objektivave të saj, Shoqëria kryen këto funksione:
 - a) zbaton programe dhe projekte për zhvillimin, përmirësimin dhe mbarështimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) krijon, administron dhe zhvillon fidanishte shtetërore për prodhimin e materialit mbjellës pyjor;
 - c) realizon veprimtari pyllëzimi, ripyllëzimi dhe rehabilitimi të sipërfaqeve pyjore, sipas programeve dhe planeve të miratuara nga autoritetet kompetente;
 - ç) kontribuon në parandalimin dhe luftimin e zjarreve në pyje, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi;

d) bashkëpunon me institucionet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sektorin privat dhe partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë për zhvillimin e veprimtarive ekonomike në sektorin pyjor, përfshirë:

- i. tregtimin e lëndës drusore dhe produkteve pyjore jo drusore, sipas legjislacionit në fuqi;
- ii. tregtimin e bimëve mjekësore, aromatike dhe eterovajore;
- iii. zhvillimin dhe administrimin e projekteve që lidhen me kreditet e karbonit dhe shërbimet e ekosistemit;

dh) ushtron çdo veprimtari tjetër të lidhur me objektin e saj, të parashikuar në statut dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Burimet Financiare

1. Shoqëria mund të financohet nga:
 - a) buxheti i shtetit për kapitalizimin e saj;
 - b) të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara ;
 - c) të ardhura nga grante, donacionet si dhe financime ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e saj të brendshme.
2. Detyrimet financiare të Shoqërisë nuk i transferohen buxhetit të shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Shoqërisë.

Neni 7

Fondi i Veçantë për Pyjet

1. Shoqëria mund të krijojë dhe administrojë një Fond të Veçantë për Pyjet, si fond i brendshëm i saj, i destinuar për financimin e veprimtarive në fushën e mbrojtjes, rehabilitimit, ripyllëzimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor.
2. Fondi i Veçantë për Pyjet financohet nga:
 - a) të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Shoqërisë;
 - b) fitimi i pashpërndarë, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme;
 - c) grante, donacione dhe financime nga partnerë kombëtarë ose ndërkombëtarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Fondi përdoret për:
 - a) financimin e masave për mbrojtjen, përmirësimin dhe rehabilitimin e ekosistemeve pyjore;
 - b) pyllëzimin, ripyllëzimin dhe rigjenerimin e fondit pyjor;
 - c) parandalimin dhe përballimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret, fatkeqësitë natyrore, dëmtuesit dhe faktorë të tjerë që cenojnë gjendjen e pyjeve;
 - ç) financimin e projekteve dhe investimeve në funksion të përmbushjes së objektivave të Shoqërisë.
4. Rregullat për krijimin, administrimin, përdorimin, monitorimin dhe raportimin e Fondit të Veçantë për Pyjet përcaktohen në statut dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës

KREU II

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 8

Bashkëpunimi me njësitë e vetqeverisjes vendore

1. Shoqëria dhe Bashkitë mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi, në të cilat përcaktohen qëllimi i marrëveshjes, të drejtat dhe detyrimet për realizimin e objektivave të qëndrueshëm në sektorin e pyjeve, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për pyjet.
2. Shoqëria nuk fiton të drejta administrimi apo përdorimi mbi fondin pyjor në pronësi ose administrim të njësisë të vetëqeverisjes vendore, përveç rasteve kur kjo parashikohet në marrëveshje bashkëpunimi, të lidhura sipas parashikimeve të këtij neni dhe legjislacionit në fuqi ose në raste të tjera të parashikuara me ligj.
3. Marrëveshja e bashkëpunimit miratohet nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Marrëveshja e parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbaton të gjitha parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Neni 9

Bashkëpunimi qendror dhe rajonal

Shoqëria për realizimin e objektivave të saj bashkëpunon me institucionet e mëposhtme, sipas fushave të tyre të kompetencës:

- a) institucionet qendrore;
- b) institucionet akademike dhe kërkimore;
- c) organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e pyjeve.

KREU III

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 10

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Shoqërisë, janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Këshilli Mbikëqyrës;
 - c) Administratori.
2. Organizimi i brendshëm i organeve drejtuese, kompetencat dhe mënyra e funksionimit të shoqërisë, përcaktohen në statutin e shoqërisë, i cili miratohet nga Asambleja e Përgjithshme

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja është organi vendimmarrës i shoqërisë lidhur me:

- a) miratimin e statutit të shoqërisë dhe ndryshimeve të tij.
- b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecures së veprimtarisë së Shoqërisë.
- c) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Shoqërisë.

Neni 12

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Shoqërinë.
4. Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen ata persona që:
 - a) nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotërojnë të paktën "master shkencor" ose më lart në fushën e pyjeve, biodiversitetit, ekonomisë, financave, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 5 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) kanë shtetësi shqiptare;

Neni 13

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron që Shoqëria gëzon autonomi operationale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:
 - a) propozon për miratim pranë Asamblesë statutin e Shoqërisë dhe ndryshimet në të;
 - b) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
- c) miraton buxhetin vjetor dhe programin financiar të Shoqërisë;
- d) miraton projektet e investimit;
- e) miraton strukturën organizative dhe organikën e Shoqërisë;
- dh) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Shoqërisë;
- e) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;
- ë) kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- f) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Shoqëria;
- g) siguron që auditimi i Shoqërisë kryhet të paktën një herë në vit;
- gj) emëron dhe liron Administratorin;
- h) përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe administratës së Shoqërisë;

 2. Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve.
 3. Këshilli Mbikëqyrës përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Shoqërisë.

Neni 14

Administratori

1. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.
2. Administratori përgjigjet përpara Këshillit Mbikëqyrës.
3. Administratori emërohet dhe lirohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Kushtet, afatet dhe rregullat e emërimit, performancës dhe lirimit përcaktohen në aktet e brendshme të Shoqërisë dhe në kontratën me Administratorin.
4. Administratori emërohet personi që:
 - a) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre ose kundërvajtjeje penale;
 - b) zotëron të paktën “master shkencor” ose më lart në fushën e pyjeve, biodiversitetit, ekonomisë, financave, drejtësisë, ose fusha të ngjashme, si dhe eksperiencë pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat;
 - c) është shtetas shqiptar.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet, por pa u kufizuar:
 - a) të administrojë veprimtarinë e Shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
 - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën e Shoqërisë;
 - dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi;
 - e) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit të Shoqërisë;
 - ë) të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit dhe akteve të brendshme të Shoqërisë.
2. Administratori përmbush detyrat e parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Shoqërisë.

Neni 16

Administrata

1. Struktura dhe organika e Shoqërisës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Marrëdhëniet e punës së personelit të Shoqërisë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Shoqërisë.

KREU IV

KONTABILITETI DHE AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 17

Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore

1. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
2. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 18

Auditimi i pasqyrave financiare

1. Auditimi i pasqyrave financiare të Shoqërisë kryhet sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të krijojë komitet të specializuar për auditimin financiar, me anëtarë dhe ekspertë të pavarur. Rregullat specifike për krijimin dhe funksionimin e komitetit të auditit përcaktohen në aktet e brendshme të Shoqërisë.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Dispozita kalimtare

Ministria përgjegjëse për pyjet, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme për:

1. sigurimin e kapitalit fillestar;
2. zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Shoqërisë;
3. miratimin e statutit të Shoqërisë;
4. regjistrimin e Shoqërisë pranë regjistrarit tregtar.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI